




---

**RAPORTI I TETË NGA MONITORIMI I  
INFORMIMIT MEDIATIK PËR PUNËN E  
KUVENDIT**

---



**KUVENDI NËN THJERRËZ**

**Përforcimi i debatit politik  
dhe diskursit deliberativ**

**PRILL 2015**



## **RAPORTI I TETË NGA MONITORIMI I INFORMIMIT MEDIATIK PËR PUNËN E KUVENDI**

**(PRILL 2015)**

Instituti për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe Instituti për Evropën Lindore dhe Qendrore dhe Ballkanin (IELQB), duke filluar nga qershori i vitit 2014 deri në mars të vitit 2015 e përcjellin nivelin e cilësisë së debatit në Kuvendin dhe raportimin e medieve nga puna e deputetëve. Monitorimi zhvillohet në kuadër të projektit “Kuvendi nën thjerrëz, përforsimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ” financiarisht i përkrahur nga Unioni Evropian. Gjatë periudhës së monitorimit do të përgatiten dhjetë raporte mujore për cilësinë e debatit në Kuvendin dhe për raportimin mediatik. Para jush është raporti i shtatë i cili ka të bëjë me raportimin e 10 medieve kombëtare në periudhën, nga 1 – 30 prill 2015.

Qëllimi i monitorimit është që në mënyrë empirike të arrihet në njohuri se në çfarë masë janë mediet pjesë e procesit të deliberacionit në shoqërinë gjatë krijimit të politikave publike, përkatësisht në çfarë masë opinionit më të gjerë ja transmetojnë argumentet e prezantuara në diskutimet kuvendore.

Pas çdo muaji të monitoruar opinionit do të informohet përmes raporteve për gjetjet kyçe të monitorimit të medieve edhe nga debati në Kuvendin.

### **A. REZYME**

Mediet në prill e zvogëluan raportimin për ngjarjet në Kuvendin. Me këtë rast, në informacionet e publikuara në të cilat përmendet Kuvendi, më shpesh në fokusin ishte kriza aktuale politike dhe mënyrat e ç’thurrjes së saj se sa puna, diskutimet dhe argumentet e deputetëve në seancat.

Burime kryesore në informacionet mediatike që kanë të bëjnë me Kuvendin në mars sërisht janë deputetët. Në vendin dytë, si burime, janë anëtarë të partive politike, ndërsa në atë të tretë, sipas përfaqësimit, janë përfaqësues nga bota e jashtme gjë e cila ka të bëjë me kyçjen e tyre në përpjekjet për zgjidhje të krizës politike në vendin. Përfaqësimi i ministrave qeveritar si burime në prill ka rënë në mënyrë të konsiderueshme në prill me muajt paraprak.

Mediet sërisht publikuan më tepër informacione në të cilat si burime janë theksuar deputetë nga një opion politik, se sa informacionet në të cilat në të njëjtën kohë janë përfaqësuar burime edhe nga pushteti edhe nga opozita. Me këtë rast, në mënyrë drastike janë përfaqësuar më shpesh janë përfaqësuar deputetë nga partitë në pushtet, ndërsa deputetët opozitar janë më pak të përfaqësuar që nga fillimi i monitorimit.

Opinionit në përgjithësi, mbetet i informuar në mënyrë të pamjaftueshme nga mediet për ngjarjet në Kuvendin, ligjet të cilat shqyrtohen dhe argumentet të cilat i prezantonin deputetët në seancat.



Kuvendi në prill të viti 2015, sërish më shpesh është përmendur në kontekst të gjendjes më të gjerë politike në shtetin dhe raportet midis partive.

Në mediet të cilat publikojnë në gjuhën maqedonase në prill janë botuar 70% të informacioneve në të cilat përmendet Kuvendi, ndërsa në mediet në gjuhën shqipe 30%. Nga informacionet e publikuara, 71% janë tekste në gazeta ditore, ndërsa 29% janë kontribute televiziv.

## B. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Monitorimi i medieve përfshin përcjellje të informacioneve të paraqitura në 10 medie kombëtare në të cilat deputetët dhe Kuvendi. Përcjellja i përfshin tekstet e botuara në gjashtë gazeta ditore nga të cilat katër janë në maqedonisht dhe dy në gjuhën shqipe. Nga kontributet televizive përcillen informacionet e transmetuara në emisionet qendrore informative në katër televizione kombëtare nga të cilat dy janë në gjuhën maqedonase, ndërsa dy janë në gjuhën shqipe. Me monitorimin janë përfshirë mediet vijuese:

### **Gazeta**

- Dnevnik
- Utrinski vesnik
- Veçer
- Sloboden pečat
- Koha
- Lajm

### **Televizione**

- Sitell
- Tellma
- Alsat-M
- RTM2 Programi në gjuhën shqipe

Në mediet e përmendura përcillen dhe analizohen informacionet në të cilat përmenden Kuvendi, deputetët dhe procedura ligjvënëse. Me këtë rast, në hulumtimin, si pjesëtarë të opozitës janë llogaritur edhe pjesëtarët e partive opozitare të cilët në zgjedhjet e fundit parlamentare morën mandate, por vendosën të mos i pranojnë. Në çdo tekst veç e veç dhe në çdo kontribut televiziv analizohen elementet kryesore përkatësisht zhanri, fokusi i informacionit, lloji, numri, pala dhe shpeshësia e burimeve

## V. KONTEKSTI POLITIK

Në pajtim me Kushtetutën dhe Kodin zgjedhor, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Njëqind e njëzet deputetë zgjedhen në lista proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh, ndërsa tre deputetë zgjedhen nga tre njësi zgjedhore në botën e jashtme. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill të vitit 2014, partia Organizata e brendshme



maqedonase revolucionare – Partia demokratike për unitet kombëtar maqedonas (VMRO-DPMNE) fitoi 61 deputet, ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin e formon qeverinë, BDI fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë Opsioni qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (RDK). Deputeti i GROM është pjesë e koalicionit në pushtet, ndërsa deputeti i cili mandatin e morri nga RDK edhe përkundër vendimit të partisë që ta bojkotojë Kuvendin ju bashkëngjiti grupit të deputetëve të BDI. Me këtë tani grupi i deputetëve të BDI numëron 20 deputetë.

Nga fillimi i monitorimit deri në botimin e këtij raporti, deputetët nga koalicioni më i madh opozitar i udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotuan punën e Kuvendit<sup>1</sup>. Në muajin dhjetor në Kuvendin si opozitarë vepronin dhjetë deputetë, shtatë nga Partia Demokratike shqiptare (PDSH) dhe tre nga koalicioni opozitar i LSDM të cilët vendosën ti pranojnë mandatet. Shumica në Kuvendin në nëntor e filloi procedurën për marrje të mandateve të 31 deputeti opozitar të cilët e bojkotojnë parlamentin. Procedura deri në botimin e këtij raporti ende nuk ka përfunduar. Kah fundi i janarit, Zoran Zaev, lideri i opozitës të udhëhequr nga LSDM në pres-konferencat filloi ti publikojë të ashtuquajturat “bomba”, përkatësisht audio incizimet komprometuese nga bisedat e ushtruesve të funksionarëve të lartë shtetëror. Më 30 mars përfaqësues të dy partive më të mëdha VMRO-DPMNE dhe LSDM u takuan në Bruksel në negociatë për zgjidhjen e krizës politike me ndërmjetësim të tre deputetëve<sup>2</sup> nga Parlamenti Evropian. Liderët e dy partive i përsëritën negociatat edhe më 15 prill mirëpo, njëjlojisi herën e parë takimet nuk sollën zgjidhje e as lëvizje përpara në gjendjen politike.


## G. GJETJE NGA MONITORIMI

Ky raport i përfshin informacionet e botuara gazetareske të cilat kanë të bëjnë ose që e prekin punën e Kuvendit në periudhën nga 1 deri më 30 prill. Janë analizuar gjithsej 92 tekste gazetareske dhe kontribute të publikuara në gazetatat dhe televizionet. Nga ato sipas:

- Llojit të medias: 71% janë në gazeta, ndërsa 29% në televizione;
- gjuhës: 70% janë të botuara në mediet në maqedonisht, ndërsa 30% në gjuhën shqipe;
- nga tekstet e botuara në mediet e shtypura, 80% janë botuar në gazeta në maqedonisht, ndërsa 20% në gazetatat në gjuhën shqipe dhe
- nga kontributet në televizionet, 44% janë të botuara në maqedonisht, ndërsa 56% në gjuhën shqipe.

<sup>1</sup> Deputetët opozitar Roza Topuzovska Ka revska nga Partia liberal-demokratike, Solza Gërçeva dhe Lubica Buralieva nga LSDM vendosën ti pranojnë mandatet e deputetit të fituara në zgjedhjet e dhe përkundër vendimit të koalicionit opozitar për bojkot të punës së Kuvendit.


<sup>2</sup> Në bisedimet në Bruksel midis përfaqësuesve të VMRO-DPMNE-së në pushtet dhe të LSDM-së opozitare ndërmjetësuan deputetët nga Parlamenti Evropian Ivo Vajgëll, Riçard Hovit dhe Eduard Kukan.



## I. ZHANRI I INFORMACIONEVE

Sipas karakteristikave të zhanrit, në prill, tekstet gazetareske në të cilat përmendet Kuvendi, në pjesën më të madhe janë të strukturuar si raporte, 62%, ndërsa në 16% si lajme të shkurtëra. Në 11% informacionet ishin të strukturura i shkrime, në 6% si analiza, ndërsa në 4% si komente os kollumna. Kjo vë në pah se mediet edhe në prill ruajtën trendin që pjesa më e madhe e informacioneve në të cilat përmendet Kuvendi të jenë informtive duke mos u bërë me këtë rast vështrim analitik ngjirjeve.

Gjithsej 78% nga informacionet e botuara në të cilat përmendet Kuvendi përmbajnë vetëm elemente informtive, ndërsa 22% përmbajnë edhe elemente analitike, trend ky që është i ngjashëm me muajtë e kaluara.





## II. FOKUSI I TEKSTEVE DHE KONTRIBUTEVE


Monitorimi i përmbajtjeve të monitoruara tregojnë se në prill mediet më rrallë kanë informuar për përmbajtjen e seancave parlamentare, për argumentet dhe qëndrimet e deputetëve krahasuar me muajin paraprak. I tillë është fokusi në 20% nga informacionet e publikuara dhe të monitoruara që është 10% më pak se sa në mars kur fokus të tillë kanë pasur madje 30% të informacioneve. Gjithashtu, në prill mediet më shpesh kanë informuar nga seancat plenare (12%), ndërsa më rrallë nga seancat e komisioneve kuvendore (8%).

Mediet më shumë informuan për seancat kuvendore në janar të vitit 2015. Atëherë për diskutimet e deputetëve dhe argumentet tyre mediet kanë informuar në 26% të informacioneve të publikuara duke e përcjellë interesin e madh publik për diskutimet rreth ligjeve për arsim të lartë dhe për honoraristët.


Në prill, në 63% të rasteve Kuvendi vetëm përmendet, por thelbi i informacionit nuk ka të bëjë me punën e deputetëve, por më shpesh me raportet midis partive dhe në përgjithësi gjendjen politike në shtetin. Kjo paraqet rritje drastike e informacioneve me fokus të tillë, për madje 37% krahasuar me muajin mars. Gjithashtu, në periudhën nga nëntori deri në shkurt Kuvendi vetëm përmendet mesatarisht në rreth 30% të informacioneve të publikuar. Në prill mediet shpesh e përmendnin Kuvendin në kontekst të të a.q. “bomba” të cilat në pres konferenca i publikon opozita, si dhe në bojkotin e parlamentit nga deputetët opozitarë.

Në 4% të rasteve informacionet e publikuara kanë të bëjnë në përgjithësi me punën e Kuvendit. Ajo është zvogëlimi kësaj përqindjeje për 7% krahasuar me marsin, dhe gjithashtu me këtë përqindje arriti nivel më të ulët në Këto informacione, në pjesë më të madhe, kanë të bëjnë në përgjithësi me punën e Kuvendit dhe raportet midis partive në të, duke mos hyrë në detaje nga seancat arriti nivel më të ulët deri tani në monitorimine deritanishëm. Këto informacione, në pjesë më të madhe, kanë të bëjnë në përgjithësi me punën e Kuvendit dhe raportet midis partive në të, duke mos hyrë në detaje nga seancat.

Në prill shënohet zvogëlim drastik i përqindjes përmbajtjeve mediatike të cilat informojnë për hyrje në fuqi të ligjeve të reja, ndryshimeve ligjore ose për ndërprerje të vlefshmërisë së dispozitave të ligjeve në 5%. Në periudhat e kaluara të monitoruara të tilla ishin 24% të përmbajtjeve të publikuara në mars, 16% në shkurt, 10% në janar.




Në prill mund të vërehet se mediet të cilat kanë publikuar informacione në gjuhën shqipe e kanë zvogëluar përqindjen e informacioneve të publikuara. Me këtë rast, mediet në gjuhën shqipe më tepër kanë publikuar informacione që kanë të bëjnë me hyrjen në fuqi të ligjeve të reja ose ndryshime të ligjeve ekzistuese.



### III. NUMRI DHE ANA E BURIMEVE

Në tekstet dhe kontributet e monitoruara në prill u rrit përqindja e informacioneve në të cilat janë theksuar dy burime për 9% krahasuar me marsin. Me atë kjo përqindje arriti 25% që është niveli më i lartë në pesë muajt e fundit të monitoruara. Përqindja e informacioneve të publikuara në të cilat janë theksuar një dhe më tepër se tre burime, shënojnë rënie të butë krahasuar me muajin mars. Ndryshim më të madh ka në përqindjen e informacioneve në të cilat nuk është theksuar asnjë burim e cila në prill u rrit për 8% krahasuar me marsin dhe arriti 12% gjë e cila njëkohësisht është vlera më e lartë për këtë kategori në 5 muajt e monitoruar të fundit. Gjithashtu, në llogari të rritjes së informacioneve me nga 3 burime ose pa kurrfarë burim, përqindja e informacioneve në të cilat janë theksur dy burime është zvogëluar për 10%, përkatësisht prej 32% në mars ka rënë në 22% në prill.







Në prill sërish njëlloj si në të gjitha muajt e kaluara burime më të shpeshta në informacionet publikuara në të cilat përmendet Kuvendi ishin deputetët, por në mënyrë të konsiderueshme më pak krahasuar me dy muajt paraprak. Në prill deputetët si burim u përfshinë në 28% të informacioneve krahasuar me 37% në mars dhe 43% në shkurt. Për llogari të zvogëlimit të përfshirjes së deputetëve si burim, këtë muaj u rrit përqindja e burimeve nga partitë politike dhe të përfaqësuesve nga bota e jashtme. Në partitë shkojnë 21% nga burimet, ndërsa në burimet “e tjera” në të cilat hynë përfaqësuesit e jashtëm, diplomatë dhe përfaqësues 19% të burimeve. Në të njëjtën kohë, në nivel më të lartë që nga fillimi i monitorimit u rrit përfaqësimi i analistëve dhe ekspertëve në informacionet mediatike në të cilat përmendet Kuvendi. Analistët dhe ekspertët janë të përfshirë në 14% nga informacionet, gjë e cila është dyfish më tepër krahasuar me muajin paraprak.

Rritja e burimeve “të tjera” ka të bëjë përfshirjen e përfaqësuesve të jashtëm, midis të cilëve përfaqësues nga Parlamenti Evropian dhe përfaqësues të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.


Në prill në mënyrë të konsiderueshme më pak kanë qenë të përfshirë anëtarë të qeverisë –7%, gjë e cila është rënie prej 13% krahasuar me muajin mars. Përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore janë të përfaqësuar në 8% nga rastet.



Në prill të vitit 2015, në 99% nga informacionet e publikuara në të cilat burimet janë deputetë janë theksuar me emër dhe mbiemër.




Nëse analizohet sipas asaj që cilit opSION politik i takojnë deputetët, të cilët si burime kanë qenë të konsultuar në tekstet dhe kontributet e gazetarëve, rezultojnë se mediet edhe në prill më shpesh kanë publikuar informacione në të cilat janë theksuar burime vetëm nga opSIONI politik, 66%. Me këtë rast vërehen ndryshime të mëdha në përfaqësimin, e informacioneve në të cilat burimet janë nga shumica qeverisëse është e rritur dyfish në 66%, ndërsa përqindja e përfshirjes së opozitës është më e ulët në monitorimin e deritanishëm të informimit mediatic për Kuvendin dhe është vetëm 3%. Në 31% të rasteve mediet, në informacionet në të cilat përmendet Kuvendi, kanë konsultuar njëkohësisht burime edhe nga pushteti edhe nga opozita.




#### IV. RUBRIKA

Sipas të dhënave nga monitorimi, në prill 37% nga tekstet dhe kontributet në të cilat është përfshirë Kuvendi kanë qenë të paralajmëruara në ballinat e gazetave ose në paralajmërimin e përgjithshëm në ditaret televizive, ndërsa 63% nuk kanë fituar vend të tillë. Në raport me rubrikat, këto informacione më shpesh, në 95% të rasteve, janë publikuar në faqet fillestare të gazetave dhe pjesët fillestare të ditareve si “Makedonija”, “Politika”, “Aktuellno” ose ngjashëm. Informacionet në të cilat përmendet Kuvendi shumë më rrallë, vetëm në 4% të rasteve, janë publikuar në rubrikat si “Komente” dhe “Kollumna”. Në prill vetëm 1% të informacioneve të monitoruara të cilat kanë të bëjnë me shtëpinë ligjvënëse janë publikuar në rubrikat të përkushtuara për ekonominë dhe biznesin, ndërsa po aq edhe në rubrikat e tj.



Në përmbajtjet e monitoruara mediatike në prill, në 71% nga tekstet dhe kontributet është theksuar, ndërsa në 29% nuk është theksuar autori i përmbytjes së publikuar në të cilën përmendet Kuvendi.



#### D. KONKLUSIONE

- Mediet edhe në prill e ruajtën trendin që pjesën më të madhe të informacioneve në të cilat përmendet Kuvendi të jenë informative duke mos i vështruar me këtë rast në mënyrë analitike ngjrrjet. Gjithsej 78% të informacioneve të publikura në të cilat përmendet Kuvendi përmbajnë vetëm elemente informative, ndërsa 22% përmbajnë edhe elemente analitike.
- Mediet në prill e zvogëluan raportimin për ngjarjet në Kuvendin, ndërsa në qendër të interesit mediatik ishin përpjekjet për zgjidhje të krizës politike në vend.
- Më tepër se dyfish krahasuar me marsin u rrit përqindja e informacioneve në të cilat Kuvendi vetëm përmendet, ndërsa përmbajtja nuk ka të bëjë me diskutimet parlamentare, por me krizën politike dhe gjendjen në shtetin si dhe në raportet midis partive. Për llogari të kësaj u zvogëlua përqindja e informacioneve të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me diskutimet parlamentare.
- Mediet më shpesh kanë konsultuar nga një burim 32%, por në prill u rrit përqindja e informacioneve në të cilat janë theksuar tre burime, por i informacioneve pa asnjë burim. Me këtë rast, burime më të shpeshta në informacionet në të cilat përmendet Kuvendi sërish ishin deputetët. Përqindja e tyre u zvogëlua krahasuar me dy muajt paraprake, ndërsa për llogari të kësaj u rrit përfshirja e burimeve nga partitë politike, përfaqësues të huaj dhe diplomatë dhe të analistëve, gjë cila në pjesë të madhe ka të bëjë me thellimin e krizës politike dhe vizitat e shpeshtuara të përfaqësuesve të huaj në vendin tonë.
- Në periudhën e vëzhguar, nga 1 deri më 30 prill në informacionet në të cilat i burime janë theksuar deputetë të Kuvendit, sërish në pjesën më të madhe, 69% janë përfshirë deputetë nga vetëm një opzion politik.
- Drastike është rënia në përfshirjen e deputetëve opozitar si burime të informacioneve si burime në informacionet duke e pasur parasysh se në ata shkojnë vetëm 3% ndërsa deputetët nga partitë në pushtet janë përfaqësuar në 66% të informacioneve. Në 31% të mbetura të informacioneve në të njëjtën kohë janë përfshirë deputetë edhe nga pushteti edhe nga opozita.



- Në mediet të cilat publikojnë në gjuhën maqedonase në prill janë publikuar 70% nga informacionet në të cilat përmendet Kuvendi, ndërsa në mediet në gjuhën shqipe 30%. Në informacionet e publikuara, 71% janë tekste në gazeta ditore, ndërsa 29% janë kontribute televizive.

\*\*\*\*\*

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ” është i financuar nga Unioni Evropian.

Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të Unionit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas civilis” – Shkup (IDSCS) dhe në kurrfarë mënyre nuk mund të llogaritet se i shfaq pikëpamjet e Unionit Evropian